

FIFA

FUTSAL

Rregullat e Lojes 2020/21




PERMBAJTJA

Faqja

Regulli

- 1 - Fusha
- 2 - Topi
- 3 - Numri i Lojtarëve
- 4 - Pajisjet e Lojtarëve
- 5 - Gjyqtarët
- 6 - Ndihmës Gjyqtarët
- 7 - Kohëzgjatja e Ndeshjes
- 8 - Fillimi e rifillimi i lojës
- 9 - Topi në lojë dhe jashtë lojës
- 10 - Mënyrat e shënimit të golit
- 11 - Pozicioni jashtë loje
- 12 - Faullat dhe sjelljet e pahijshme
- 13 - Goditjet e lira
- 14 - Penalltia
- 15 - Rivënia anësore
- 16 - Rivënia fundore
- 17 - Goditja nga këndi

Sinjalizimi
Pozicionimi
Interpretime dhe rekomandime



Përmasat

Gjatësia e vijës anësore duhet të jetë më e madhe se gjatësia e vijës fundore


Të gjitha vijat duhet të jenë 8cm të gjera.

Për ndeshje jo ndërkombëtare përmasat e fushës janë si vijon:

Gjatësia (vija anësore)	minimumi	25m
	maksimumi	42m
Gjerësia (vija fundore)	minimumi	16m
	maksimumi	25m

Për ndeshje ndërkombëtare përmasat janë si vijon:

Gjatësia (vija anësore)	minimumi	38m
	maksimumi	42m
Gjerësia (vija fundore)	minimumi	20m
	maksimumi	25m




Zona e Penalltisë

Dy vija imagjinare me gjatësi 6m vizohen prej pjesës së jashtme të shtyllave të portës dhe në kënd të drejtë me vijën fundore; në fund të këtyre vijave, një çerek rrethi vizatohet në drejtim të vijës anësore më të afërt, secili me rreze 6m prej pjesës së jashtme të shtyllave të portës. Pjesa e sipërme e çdo çerek rrethi bashkohët nga një vijë me 3.16m gjatësi, që shkon paralel me vijën e portës. Sipërfaqja që rrethohet nga këto vija dhe vija fundore, është zona e penalltisë.

Brenda seciles zonë të penalltisë, shenjohehet një pikë, 6m nga pika e mesit të vijës së portës, dhe e barazlarguar nga shtyllat pingule të portës. Kjo pikë ka rreze 6cm.

Një shenjë (vijë) shtesë duhet të bëhet në zonën e penalltisë, 5 metra nga shenja 10 metra, për të siguruar që portierët të zbatojnë distancën e 5 metrave në rastet kur kemi një goditje direkte që perkon me faullin e gjashtë të akumuluar. Kjo shenjë është 8cm e gjerë dhe 40cm e gjatë.



Pika e Penalltisë 10 metra

Një pikë e dytë shënohet 10m nga pika e mesit të portës dhe barazlarguar nga shtyllat pingule.

Dy shenja shtesë, përkatësisht në një distancë prej 5m në të majtë dhe në të djathtë të shenjës 10m, janë të vendosura për të treguar distancën minimale që lojtarët duhet të mbajnë kur kemi një goditje direkte nga shenja 10m. Këto shenja janë në formë rrethore me një rreze prej 4cm secila.

Gjithashtu këto shenja krijojnë një vijë imagjinare e cila është e barazlarguar 10m nga vija fundore. Në këtë zonë të krijuar nëse kryhet faull i cili perkon me faullin e 6 dhe respektivisht penallti, ekipi i cili egzekuton penalltinë mund të zgjedhë ta gjuajë penalltinë nga pika e 10 metrashit ose nga vendi ku është shkaktuar faulli.

Zona e zëvendësimit

Zonat e zëvendësimit ndodhen mbi vijën anësore përpara pankinave të secilit ekip:

- Ato ndodhen përballë zonës teknike dhe janë të larguara 5m nga vija e mesit të fushës. Gjatesia e zonës është 5m. Janë të kufizuara në çdo skaj me një vijë 80cm të gjatë dhe 8cm të gjërë. 40cm të këtyre linjave është e vendosur në pjesën e brendshme të fushës dhe 40cm se ciles ndodhen brenda dhe 40cm jashtë fushës me gjërësi 8cm.
- Zona e zëvendësimit të një skuadre ndodhet në gjysmefushën të mbrojtur nga sukadra në fjalë. Zona e zëvendësimit të skuadrave ndryshen në pjesën e dytë të ndeshjes dhe në pjesët shtesë (nese ka)

Me shumë detaje mbi zëvendësimet dhe procedurat do të jenë të shpjeguara në rregullin 3.

Zona e kornes


Një linjë në formë çerek rrethi me një rreze prej 25cm ndodhet në çdo kënd brenda fushës. Linja është e gjërë 8cm.

Zona teknike

Zona teknike është një zonë e veçantë për stafin teknik dhe rezervat.

Ndërsa përmasat dhe pozicioni i zonave teknike mund të ndryshojnë sipas sallave, shënimet e mëposhtme janë udhërrëfyes i përgjithshëm:

- zona teknike zgjatet 1m në çdo anë të ndenjësve dhe zgjatet përpara tyre deri në një largësi prej 75cm nga vija anësore.
- udhëzohet që të përdoren vizime për të përcaktuar këtë zonë.
- numri i njëzëzve që qëndrojnë në zonën teknike përcaktohet në rregulloren e garës.
- personat që qëndrojnë në zonën teknike:
 - identifikohen përpara ndeshjes në përputhje me rregulloren e garës;
 - duhet të sillen në mënyrë të përgjeshme.
 - duhet të qëndrojnë brenda kufijve të saj, përveç rastëve speciale si psh: fizioterapist/doktor hyjnë në fushë me lejen e njerit për arbitrave të ndeshjes për të mjekuar një lojtar të demtuar.
- vetëm një person lejohet të japë udhëzime ekipit dhe të qëndroje në këmbë.
- rezervat të shoqëruar nga një ndihmes trajner mund të kryejnë nxemje gjatë ndeshjes në zonën e caktuar për këtë qëllim, përderisa ata nuk pengojnë lëvizjet e lojtarëve dhe gjyqtarëve dhe sillen përgjegjshëm.



Portat

Portat vendosen në mes të çdo vije fundore.

Nje porte konsiston ne dy shtylla pingule, qe duhet te jene te baraslarguara nga kendet dhe te bashkohen me njera tjetren ne krye me nje shtylle horizontale. Shtylla horizontale dhe ato pingule duhet te jene prej material te miratuar nga FIFA. Shtyllat mund te kene forme katrore ose te rrumbullaket dhe nuk duhet te paraqesin rrezik per lojtaret.


Largësia (e brendëshme) midis shtyllave pingule është 3m dhe largësia midis pjesës se poshtme të shtyllës horizontale (traut të portës) dhe terrenit, është 2m.

Të gjitha shtyllat kanë të njëjtën trashësi, 8cm. Rrjetat duhet të jenë prej najloni ose çdo material tjetër. Ato duhet të jenë fiksuar mirë dhe nuk duhet të pengojnë portierin.

Nëse njera nga shtyllat demtohet ose leviz, loja nderpritet derisa problemi te riparohet. Nese kjo gje nuk eshte e mundur ndeshja nderpritet.

Ne rastin kur shtylla riparohet ndeshja fillon me top te diskutueshem ne vendin ku loja ishte ndalur, pervec rastit kur loja eshte ndalur brenda zones se penalltise.

Portat duhet të jenë të ngulura mirë në terren, që të mos rrëzohen. Portat lëvizëse mund të përdoren, vetëm nëse janë të sigurt.



Rregulli 2 - TOPI

Vecorite dhe permasat

Topi është:

- sferik (i rrumbullaket)
- prej materiali te pershtatshem
- me perimetër midis 62cm dhe 64cm
- me peshë midis 400g dhe 440g në momentin e fillimit të ndeshjes
- me nje presion 0.6 – 0.9 atmosfere (600 – 900 g/cm²) në nivelin e detit
- topi nuk duhet të kërcejë me pak se 50cm ose më shumë se 65cm, në kërcimin e parë pasi lëshohet nga një lartësi prej 2m

Logot mbi top

Te gjithë topat qe perdoren ne ndeshje duhet te jene te miratuar nga FIFA ose konfederatat si me poshte:

- logo zyrtare “MIRATUAR NGA FIFA” (FIFA APPROVED)
- logo zyrtare “INSEPKTUAR NGA FIFA” (FIFA INSPECTED)
- logo “TOP STANDARD I NDESHJEVE NDËRKOMBËTARE” (INTERNATIONAL MATCHBALL STANDARD)



Një logo e tillë mbi top tregon që topi është provuar zyrtarisht dhe është gjetur në përputhje me kërkesat specifike teknike.

Kompeticionet e Federatave anëtare mundet gjithashtu të kërkojnë përdorimin e topave që përmbajnë logo të tilla.

Rreklammat mbi top

Në ndeshjet zyrtare të organizuara nga FIFA, Konfederatat apo Federatat anëtare, nuk lejohet asnjë formë reklame mbi top, përveç stemës së kompeticionit (garës), organizatorit të kompeticionit dhe logon e autorizuar të prodhuesit të topit. Rregullorja e kompeticionit mund të kufizojë numrin dhe përmasat e këtyre reklamave.

Zevendesimi i nje topi me defekt

Nëse topi plas apo del jashte perdorimit gjatë lojës, ndeshja nderpritet:

- Ndeshja rifillon me top të diskutueshëm, qe hidhet në vendin ku topi i mëparshëm ku topi i mëparshëm doli jashte perdorimit. Në rast se loja eshte ndaluar brenda zones se penaltise, gjygtari e hedh topin e diskutueshem ne vijen e zones se penaltise.

Në rast se topi shpohet apo dëmtohet kur nuk është në lojë (gjatë goditjes nga qendra, rivënia

fundore, top i disputueshëm, goditje e lirë, penalti ose rivënie anësore):

- loja rifillon në përputhje me Rregullat e Lojës se Futsallës.

Topi nuk mund të ndryshohet gjatë lojës pa lejen e gjyqtarëve.

Rregulli 3 –LOJTARET

Numri i lojtarëve

Ndeshja luhet me dy ekipe, secili i përbërë nga jo më shumë se pesë lojtarë, një prej të cilëve është portier.

Ndeshja nuk mund të fillojë nëse një nga ekipet ka më pak se tre lojtarë.

Ndeshja mund të braktiset nëse një nga ekipet ka më pak se tre lojtarë në fushë.

Nëse një ekip ka më pak se tre lojtarë sepse një ose më shumë lojtarë janë larguar qëllimisht

nga fusha, gjyqtarët nuk janë të detyruar të ndalojnë lojën dhe avantazhi mund të praktikohet,

por ndeshja nuk duhet të rifillojë pasi topi të dalë jashtë loje nëse një ekipi nuk ka numrin minimal të tre lojtarëve

Numri i zëvendësimeve dhe i zëvendësuesve

Numri i zëvendësimeve që mund të kryhen gjatë një ndeshje është i pakufizuar.

Ndeshjet zyrtare

Një maksimum prej nëntë zëvendësuesish mund të përdoren në një ndeshje të luajtur në një kompeticion zyrtar të organizuar nën kujdesin e FIFA-s, konfederatave ose shoqatave anëtare. Rregullat e kompeticionit duhet të tregojnë se sa zëvendësues mund të lejohen.

Ndeshjet e tjera

Në ndeshjet jozyrtare të ekipit kombëtar "A", maksimumi i lojtareve zëvendësues është dhjetë.

Në të gjitha ndeshjet e tjera, mund të kemi një numër më të madh të lojtareve zëvendësuesish me kusht që:

- ekipet përkatëse arrijnë marrëveshje për një numër maksimal;
- gjyqtarët të informohen para ndeshjes.

Nëse gjyqtarët nuk janë të informuar, ose nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje para ndeshjes, nuk lejohen më shumë se dhjetë lojtarë zëvendësues.

Paraqitja e listës së lojtareve dhe zëvendësuesve

Në të gjitha ndeshjet, një listë e plotë me emrat e lojtarëve dhe zëvendësuesve duhet t'u jepet gjyqtarëve përpara fillimit të ndeshjes, pavarësisht nëse lojtarët apo rezervat janë të pranishëm apo jo. Çdo lojtar rezervë, emri i të cilit nuk përfshihet në këtë listë, nuk mund të marrë pjesë në ndeshje.

Procedura e zëvendësimit

Zëvendësimi mund të kryhet në çdo kohë, edhe nëse topi është në lojë apo jo. Për të zëvendësuar një lojtar me një rezervë, duhen vëzhguar këto kushte:

- Lojtari që zëvendësohet nuk ka nevojë për lejen e arbitrave për të lënë fushën e lojës.
- Arbitrat nuk ka nevojë të autorizojnë zëvendësuesin për futjen në fushën e lojës.
- lojtari largohet nga fusha në zonën e zëvendësimit të ekipit të vet, përveç rasteve që parashikohen ndryshe në Rregulloren e Futsallës
- lojtari rezervë hyn në fushë vetëm pasi lojtari që zëvendësohet ka dale prej saj
- lojtari rezervë hyn në fushë në zonën e zëvendësimit
- zëvendësimi është kryer kur lojtari rezervë ka hyrë në fushë prej zonës së zëvendësimit
- prej atij casti, lojtari rezervë bëhet lojtar aktiv dhe lojtari që ai zëvendësoi bëhet lojtar rezervë
- lojtari i zëvendësuar mund të marrë pjesë në lojë sërish
- të gjithë lojtarët rezervë ndodhen nën autoritetin dhe juridiksionin e gjyqtarëve, pavarësisht nëse luajnë apo jo
- nëse një periudhë kohe zgjatet që të kryhet një penallti (6m), një goditje nga pika dytë e penalltisë (10m) apo një goditje e lirë pa mur mbrojtës, vetëm portieri i ekipit mbrojtës mund të zëvendësohet

Nxemja e lojtareve rezerve

Maksimumi pesë zëvendësues për ekip lejohen të jenë në zonën e caktuar për nxemje në të njëjtën kohë.

Zëvendësimi i portierit

- çdo lojtar mund të ndërrojë vendin me portierin
- çdo rezervë mund të ndërrohet me portierin pa qenë nëvoja të njoftohen gjyqtarët ose që loja të jetë e ndalur
- lojtari aktiv që ndërron pozicionin me portierin, duhet ta bëjë këtë kur loja është e ndalur dhe duhet të njoftojë gjyqtarët përpara se të bëhet ndërrimi
- lojtari apo rezerva që zëvendëson portierin duhet të veshë fanellë të njëjtë në ngjyrë me atë të portierit, por me numrin e tij.

Shkeljet dhe ndeshkimet

Nëse një rezervë hyn në fushë më parë se sa lojtari që do të zëvendësohet të ketë dalë prej saj, ose nëse gjatë zëvendësimit, një rezervë hyn në fushë jo nëpërmjet zonës së zëvendësimit:

- gjyqtarët ndalojnë lojën (megjithëse jo menjëherë nëse ka mundësi të zbatohet përparësia (avantazhi)
- gjyqtarët e ndëshkojnë atë me karton të verdhë për shkelje të rregullit të zëvendësimit dhe e urdhërojnë të largohet nga fusha

Nëse loja është ndaluar, ajo rifillon me goditje indirekte për ekipin kundërshtar, atje ku ndodhet topi në momentin e ndalimit të lojës (shih Rregulli 13)

Nëse lojtari rezervë apo ekipi i tij, kryejnë edhe një shkelje tjetër, loja rifillon në përputhje me kapitullin e titulluar “Interpretimi i Rregullave të Lojës së Futsallës dhe Udhërrëfyesi për Gjyqtarët” (Rregulli 3).

Nëse, gjatë një zëvendësimi, lojtari që zëvendësohet largohet nga fusha për arsye që nuk parashikohen në Rregulloren e Futsallës dhe nga një vend tjetër veç zonës së zëvendësimit:

- gjyqtarët ndalojnë lojën (megjithëse jo menjëherë nëse mund të zbatohet avantazhi)
- gjyqtarët e ndëshkojnë lojtarin për shkelje të rregullit të zëvendësimit

Nëse loja është ndaluar, ajo rifillon me goditje indirekte për ekipin kundërshtar në vendin ku ndodhet topi në momentin e ndalimit të lojës (shih Rregulli13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Në të gjitha rastet e tjera të shkeljes së këtij Rregulli:

- lojtarët shkeles ndëshkohen me karton të verdhë
- loja rifillon me goditje indirekte për ekipin kundërshtar në vendin ku ndodhet topi në momentin e ndalimit të lojës (Rregulli13 – Pozicioni i goditjes së lirë). Në raste të veçanta, loja rifillon në përputhje me kapitullin e titulluar “Interpretimi i Rregullave të Lojës së Futsallës dhe Udhërrëfyesi për Gjyqtarët” (Rregulli 3)

Lojtaret dhe zevendesuesit qe ndeshkohen me karton te kuq

Një lojtar që ndëshkohet me karton të kuq përpara fillimit të ndeshjes mund të zëvendësohet nga një lojtar rezervë që është në listën e protokollit të ndeshjes.

Një lojtar rezervë që ndëshkohet me karton të kuq, përpara fillimit të ndeshjes ose edhe gjatë saj, nuk mund të zëvendësohet.

Një lojtar rezervë mund të zëvendësojë një lojtar aktiv të ndëshkuar me karton të kuq dhe të hyjë në fushën e lojës, dy minuta të plotë pasi lojtari është nxjerrë jashtë, me kusht që të jetë autorizuar nga kohëmbajtësi ose gjyqtari i tretë (ndihmës gjyqtarët), veç në rast se shënohet gol përpara përfundimit të dy minutave, në ç’rast duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- nëse luajnë pesë kundër katër dhe ekipi me më shumë lojtarë shënon gol, ekipi me katër lojtarë mund të plotësohet me lojtarin e pestë
- nëse të dy ekipet luajnë me tre ose katër lojtarë dhe shënohet gol, të dy ekipet mbetën me të njëjtin numër lojtarësh

- nëse luhet pesë kundër tre, ose katër kundër tre, dhe ekipi me më shumë lojtarë shënon gol, ekipi me tre lojtarë mund të shtohet vetëm me një lojtar tjetër
- nëse ekipi që shënon gol, është ekipi me më pak lojtarë, loja vazhdon pa u ndryshuar numri i lojtarëve

Persona te tjere ne fushe

Trajneri dhe zyrtarë të tjerë të përmendur në listën e ekipit janë zyrtarë të ekipit.

Kushdo që nuk përmendet në listën e ekipit si lojtar, zëvendësues ose zyrtar i ekipit konsiderohet një agjent i jashtëm.

Nëse një zyrtar i ekipit, zëvendësues (përveç si pjesë e procedurës së zëvendësimit), lojtar i dërguar ose agjent i jashtëm hyn në fushë, gjyqtarët duhet:

- ndalojnë lojën vetëm nëse ka ndërhyrje në lojë;
- largojnë personin kur ndalet loja;
- ndërmarrin masa disiplinore.

Nëse loja ndalet dhe ndërhyrja bëhet nga:

- një zyrtar i ekipit, lojtar zëvendësues ose lojtar i ndeshkuar me karton të kuq, loja duhet të rifillojë me goditje dënimi, penallti.
- një agjent i jashtëm, loja rifillon me top të diskutueshem.

Arbitrat duhet të raportojnë incidentin tek autoritetet përkatëse.

Goli i shenuar me persona shtese ne fushen e lojes

Nëse, pas një goli të shenuar, gjyqtari e kupton para se loja të rinisë, se ishte një person shtesë në fushën e lojës kur u shënuar goli:

Gjyqtari duhet ta anulojë golin në qoftë se:

- Personi shtesë ishte një faktor i jashtëm dhe ai ndërhyri në rrjedhën e lojës;
- Personi shtesë ishte lojtar, zëvendësues, lojtar i zëvendësuar apo staf teknik që i perkiste skuadres që shënoi golin.

Gjyqtari duhet ta quajë golin të vlefshëm në qoftë se:

- Personi shtesë ishte një faktor i jashtëm dhe ai nuk ndërhyri në rrjedhën e lojës.
- Personi shtesë ishte lojtar, zëvendësues, lojtar i zëvendësuar apo staf teknik i skuadres që shënoi golin.

Kapiteni i ekipit nuk ka status ose privilegje të veçantë, por ka një shkallë të përgjegjësisë për sjelljen e ekipit.

Rregulli 4 – PAJIMET E LOJTAREVE

Siguria

Lojtarët nuk mund të përdorin apo veshin pajisje që mund të jenë të rrezikshme për atë vetë apo për lojtarët e tjerë (përfshirë edhe çdo lloj argjendarie).

Pajimet baze

Pajimet bazë të një lojtari perbehen nga objektet e mëposhtme të ndara nga njera-tjetra:

- fanellë me menge. Nëse poshte saj vishen bluza të tjera, ngjyra e mengeve duhet të jete ne te njeiten ngjyre me ate te mengeve te fanelles.
- Te mbathura. Nese poshte tyre vishen mbathje te tjera, ngjyra e tyre duhet te jete me te njeiten ngjyre me ate te te mbathuave.
- Corape
- Mbrojtëse të kercinjve
- Kepuce

Ngjyrat

- Dy skuadrat duhe te veshin uniforma me ngjyra qe i dallojne nga njera-tjetra, nga gjyqtaret.
- Çdo portier duhet të veshë uniforme me ngjyre qe e dallon nga lojtaret e tjere dhe nga gjyqtaret.

Pajime te tjera

Lejohen pajisje mbrojtëse jo të rrezikshme - për shembull, mbulesat e kokës, maskat e fytyrës dhe mbrojtëset e gjurit dhe krahëve të bëra prej materiali të butë.

Reklamat ne pajimet baze te lojtareve

Lojtarët nuk duhet të tregojnë veshje të brendëshme që përmbajnë reklama apo parrulla. Pajisjet bazë të detyrueshme nuk duhet të kenë asnjë fjali me përmbajtje politike, fetare apo personale.

Një lojtar që heq fanellën për të treguar parrulla apo reklama duhet të ndëshkohet nga organizatorët e kompeticionit (garës). Ekipi i lojtarit në pajisjet bazë të detyrueshme të të cilit ka parrulla apo fjali me përmbajtje politike, fetare ose personale do të ndëshkohet nga organizatorët e kompeticionit (garës) ose nga FIFA.

Shkeljet dhe ndeshkimet

Në rast të cfaredo shkeljeje të këtij rregulli:

- Loja nuk duhet të nderpritet
- në rastin me të parë që topi nuk është në lojë, lojtari shkeles këshillohet nga gjyqtari të largohet nga fusha e të rregullojë pajisjet, veçse ai nderkohë i ka rregulluar ato
- çdo lojtar që i kërkohet të lergohet nga fusha të rregullojë pajisjet e tij, nuk mund të ri-hyjë në fushë pa lejen e gjyqtarëve ose të gjyqtarit të tretë
- gjyqtarët, vetë ose nëpërmjet gjyqtarit të tretë, kontrollojnë që pajisjet e lojtarit janë në rregull përpara se ta lejojnë që të ri-hyjë në fushë
- lojtari, nëse nuk është zëvendësuar, lejohet të ri-hyjë në fushë kur topi nuk është në lojë ose nën vëzhgimin e gjyqtarit të tretë kur topi është në lojë

Një lojtar që është këshilluar të largohet nga fusha për shkelje të këtij Neni dhe nuk është zëvendësuar, por ri-hyn në fushë pa lejen e gjyqtarëve ose të gjyqtarit të tretë, duhet ndëshkuar me karton të verdhë.

Rifillimi i lojes

Nëse loja është ndaluar nga gjyqtarët për të ndëshkuar një lojtar:

- loja rifillon me goditje të lirë dykalimshe (indirekte) për ekipin kundërshtar, në vendin ku ndodhej topi në momentin e ndalimit të lojës (shih neni 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Rregulli 5 – GJYQTARET

Autoriteti i gjyqtareve

Çdo ndeshje kontrollohet nga dy gjyqtarë, gjyqtari dhe gjyqtari i dytë, të cilët janë të plotëfuqishëm të sigurojnë zbatimin e Rregullores së Lojës së Futsallës në ndeshjen për të cilën janë caktuar.

Fuqite dhe detyrat

Gjyqtarët:

- sigurojnë zbatimin e Rregullores së Lojës së Futsallës
- kontrollojnë ndeshjen në bashkëpunim me ndihmës gjyqtarët, në rast se ka
- sigurojnë që çdo top i përdorur plotëson kërkesat e Regullit 2
- sigurojnë që pajisjet e lojtarëve të plotësojnë kërkesat e Regullit 4
- mbajnë shënime për ndeshjen
- ndalojnë lojën, nëse në gjykimin e tyre, ka shkelje të Rregullores së Lojës së Futsallës
- ndalojnë lojën për ndërhyrje të jashtme të çdo lloji
- ndalojnë lojën, nëse në mendimin e tyre, një lojtar është lënduar seriozisht dhe sigurojnë që ai të largohet nga fusha. Një lojtar i dëmtuar mund të rikthehet në fushë vetëm pasi loja ka rinisur
- lejojnë lojën të vazhdojë deri sa topi të mos jetë me në lojë, nëse në mendimin e tyre, një lojtar është lënduar vetëm lehtë
- sigurojnë që një lojtar që ka rrjedhje gjaku të largohet nga fusha. Lojtari mund të rikthehet vetëm me lejen e gjyqtarëve, të cilët duhet binden, vetë ose nëpërmjet gjyqtarit të tretë, që rrjedhja e gjakut është ndaluar
- lejojnë lypjen të vazhdojë kur ekipi ndaj të cilit është bërë shkelje mund të përfitojë nga një përparasi e tillë dhe ndëshkojnë shkeljen e mëparshme nëse përparësia e lejuar nuk kryhet vërtet
- ndëshkojnë shkeljen me të rënde nëse një lojtar shkakton me shumë se një shkelje në të njëjtën kohë
- ndëshkojnë sjelljen e pahijshme me të rënde në rast se një lojtar kryen disa sjellje të pahijshme në të njëjtën kohë
- marrin masa ndëshkuese me karton të verdhë ose të kuq ndaj lojtarëve fajtorë për shkelje të tilla. Nuk janë të detyruar ta bëjnë këtë menjëherë, por patjetër në

rastin me të parë që topi nuk është në lojë

- marrin masa ndaj zyrtarëve të ekipeve, të cilët nuk sillen në mënyrë të përgjegjeshme dhe mund t'i përjashtojnë ata nga zona teknike dhe nga afërsitë e fushës
- sigurojnë që asnjë person i pa autorizuar të mos hyjë në fushë
- sinjalizojnë rifillimin e lojës pasi ajo ka qënë ndalur
- përdor shenjat sinjalizuese që përshkruhen në kapitullin “Shenjat e Gjyqtarit dhe Ndhmës Gjyqtarit”
- qëndrojnë në fushë në pozicionet që përshkruhen në kapitullin “Pozicionet kur topi është në lojë”, që është pjesë e kapitullit “Interpretimi I Rregullave të Lojës së Futsallës dhe Udhërrëfyeti për Gjyqtarët” (Rregulli 5 – Gjyqtarët), kur u kërkohet të mbajnë ato pozicione
- u paraqesin autoriteteve përkatëse protokollin e ndeshjes, ku përshkruhet çdo ngjarje apo masë ndëshkimore të marrë ndaj lojtarëve apo zyrtarëve dhe çdo incident tjetër që mund të ketë ndodhur para, gjatë apo pas zhvillimit të ndeshjes.

Gjyqtari:

- nëse mungojnë kohëmbajtësi dhe gjyqtari i tretë, kryen detyrat e tyre
- pezullon ose braktis ndeshjen, sipas gjykimit të tij, për çdo shkelje të Rregullores së Lojës së Futsallës
- pezullon ose braktis ndeshjen për shkak të ndërhyrjeve të çdo lloji

Gjyqtari i dytë:

- zëvendëson gjyqtarin në rast se ai lëndohet ose nuk mund të vazhdojë me.

Vendimet e gjyqtareve

Vendimet e gjyqtarëve për ngjarje që lidhen me lojën, përfshirë nëse është shënuar gol apo jo dhe rezultatin e ndeshjes, janë përfundimtare.

Gjyqtarët mund të ndryshojnë një vendim kur kuptojnë se është i gabuar, në gjykimin e tyre, ose pas këshillimit me ndihmës gjyqtarët, vetëm në rast se nuk e kanë rifilluar ose përfunduar ndeshjen.

Vendimet e gjyqtarit janë parësore ndaj gjyqtarit të dytë, nëse të dy sinjalizojnë një shkelje por nuk bien dakord për vendimin.

Në rast të ndërhyrjeve pa vend apo sjelljeve të pahijshme, gjyqtari mund të lirojë nga detyra gjyqtarin e dytë ose ndihmës gjyqtarët, merr masa që të zëvendësohen dhe raporton te autoritetet përkatëse

[Pergjessite e gjyqtareve](#)

Gjyqtarët (dhe në disa raste ndihmës gjyqtari) nuk mbajnë përgjegjes për:

- asnjë lloj lendimi (dëmtimi) të lojtarëve, zyrtarëve apo shikuesve
- asnjë dëmtim të pronësise se çdo lloji
- asnjë humbje tjetër pesuar nga ndonjë person, klub, kompani, shoqatë apo organizatë tjetër, që mund të jetë për shkak të ndonjë vendimi që gjyqtarët marrin në përputhje me Rregulloren e Lojës së Futsallës, ose në përputhje me procedurat që kerkohen për të mbajtur, luajtur apo kontrolluar një ndeshje

Vendime të tilla mund të përfshijnë:

- vendimin në lidhje me lejimin apo mos lejimin e zhvillimit të ndeshjes për shkak të kushteve të fushës dhe rrethimit të saj ose të kushteve të motit
- vendimin për të braktisur ndeshjen për çfarë do lloj arsyeje
- vendimin për përshtatshmërinë e fushës, pajisjeve dhe topit që përdoren gjatë ndeshjes
- vendimin për të ndalur apo jo ndeshjen në rast ndërhyrjeje të shikuesve apo problemeve në shkallët e shikuesve
- vendimin për të ndalur ose jo lojën që t'i jepet ndihma e parë një lojtari të lënduar
- vendimin për t'i kerkuar një lojtari të lënduar të largohet nga fusha të marrë ndihmen mjekësore
- vendimin për të lejuar ose jo një lojtar të ketë një veshje apo pajisje të caktuar
- vendimin (kur e kanë autoritetin, pushtetin) të lejojnë ose jo çdo person (përfshirë zyrtarë të ekipeve apo vendit ku luhet, personëlin e sigurisë, fotografët ose përfaqësues të tjerë të mediave) të qëndrojnë në afërsi të fushës
- çdo vendim tjetër që ata mund të marrin në përputhje me Rregulloren e Lojës së Futsallës ose me detyrat e caktuar nga FIFA, konfederatat, federatat anëtare ose rregulloren e brendëshme të kompeticionit (garës) që luhet ndeshja

[Ndeshjet ndërkombetare](#)

Gjyqtari i dytë është i detyrueshëm për ndeshjet ndërkombëtare

[Ndhimes gjyqtari rezerve](#)

Në turne apo kompeticione (gara) ku caktohet një ndihmës gjyqtar rezervë, roli dhe detyrat e tij duhet të jenë në përputhje me udhërrëfyesin e kësaj Regulloreje.

Rregulli 6 – NDIHMES GJYQTARET

[Autoriteti i ndihmes gjyqtareve](#)

Mund të caktohen 2 ndihmës gjyqtarë (gjyqtari i tretë dhe kohëmbajtësi) që duhet t'i përmbushin detyrat e tyre në përputhje me Rregulloren e Lojës së Futsallës. Ata qëndrojnë jashtë fushës, në vazhdimësi të vijës së gjysemfushës dhe në të njëjtën anë ku ndodhen zonat e zëvendësimit (bankinat e ekipeve). Kohëmbajtësi qëndron ulur në tryezën e tij, ndërsa gjyqtari i tretë mund të përmbushë detyrat e veta ulur ose në këmbë.

Kohëmbajtësi dhe gjyqtari i tretë pajisen me një kohëmatës (kronometër) të përshtatëshëm dhe pajisjet e tjera të nevojshme për të mbajtur shënim faullat e akumuluar, të cilat u sigurohen nga federata ose klubi në vendin e të cilit zhvillohet ndeshja.

Atyre u sigurohet një tryezë me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre me përpikëri.

Autoriteti dhe detyrat

Gjyqtari i tretë:

- ndihmon gjyqtarët dhe kohëmbajtësin
- mban shënim lojtarët që marrin pjesë në ndeshje
- vëzhgon zëvendësimin e topave me kërkesë të gjyqtarëve
- kontrollon pajisjet e lojtarëve përpara se ata të hyjnë në fushë
- mban shënim numrat golëshënuesve
- njofton kohëmbajtësin për kërkesën për 1 minutë pushim (time-out) kur e kërkojnë zyrtarët e ekipeve (shih Neni 7 – Kohëzgjatja e Ndeshjes)
- tregon sinjalin e detyrueshëm të pushimit (time-out) pasi kohëmbajtësi i ka renë sirenës, për të njoftuar gjyqtarët dhe ekipet që është koha për 1 minutë pushim
- mban shënim pushimet (time-out) e kërkuara
- mban shënim faullat e akumuluar të dhena nga gjyqtarët për çdo ekip në çdo pjesë loje
- tregon sinjalin e detyruar që një ekip ka shkaktuar pesë faulla të akumuluar në një pjesë loje
- vendos një shenjë të dukshme mbi tryezë për të treguar që një ekip ka plotësuar numrin pesë të faullave të akumuluar në një pjesë loje
- mban shënim emrat dhe numrat e lojtarëve që ndëshkohen me karton të verdhë ose të kuq
- u jep një dokument zyrtarëve të ekipeve përpara fillimit të çdo pjesë loje, me anë të të cilit ata kërkojnë pushimin (time-out) dhe e merr mbrapsht në fund të çdo pjesë në rast se nuk është përdorur
- u jep një dokument zyrtarëve të ekipeve ku shënohet koha kur një lojtar rezervë mund të hyjë në fushë për të zëvendësuar një lojtar që është nxjerrë jashtë me karton të kuq
- nen vëzhgimin e gjyqtarëve, kontrollon ri-hyrjen në fushë të një lojtari që ishte larguar prej saj për të rregulluar pajisjet e veta
- nen vëzhgimin e gjyqtarëve, kontrollon ri-hyrjen në fushë të një lojtari që ishte larguar prej saj për arsye lëndimi (dëmtimi)
- njofton gjyqtarët në rast të ndonjë gabimi të dukshëm në ndëshkimin e një lojtari (karton i verdhë ose i kuq) ose kur ka sjellje të dhunëshme që gjyqtarët nuk e kanë parë. Në çdo rast, gjyqtarët vendosin përfundimisht për ngjarje në lidhje me lojën.
- vëzhgon sjelljen e personave në zonën teknike dhe në bankina dhe njofton gjyqtarët për ndonjë sjellje të pa përshtatëshme
- mban shënim kohën e ndërprejeve e lojës për shkak të ndërhyrjeve të jashtme dhe arsyt e tyre
- siguron çdo informacion tjetër të rëndësishëm për ndeshjen qëndron në fushë, sic përshkruhet në kapitullin “Pozicioni në situatë kur topi nuk është në lojë”, i cili është pjesë e “Interpretimi i Rregullave të Lojës së Futsallës” (Neni 5 – Gjyqtarët), kur i kërkohet një gje e tillë
- zëvendëson gjyqtarin e dytë në rast se gjyqtari ose gjyqtari i dytë lëndohen (dëmtohen) ose mungojnë

Kohëmbajtësi:

- siguron që zgjatja e ndeshjes bëhet në përputhje me kërkesat e Regullin 7:
 - fillon kohëmatësin (kronometrin) kur goditja nga qendra është kryer në rregull
 - ndalon kohëmatësin kur topi nuk është në lojë
 - e rifillon atë pasi loja ka nisur rregullisht pas rivënies anësore, rivënies fundore, goditjes nga këndi ose nga qendra, goditjes së lirë, goditjes nga pika e penaltisë ose pika e dytë e penaltisë, ose topit të disputueshëm
- shënon golat, faullat e akumuluar dhe pjesët e lojës në tabelën elektronike, nëse ka një të tillë
- njofton kërkesën për 1 minutë pushim (time-out) me siren ose bilbil të ndryshëm nga ai që përdorin gjyqtarët, pasi e ka njoftuar gjyqtari i tretë
- mat kohën e pushimit 1 minutë
- njofton përfundimin e 1 minutë pushim
- njofton faullin e pestë të akumuluar nga ekipet pasi është njoftuar nga gjyqtari i tretë
- mat kohën 2 minuta të nxjerrjes jashtë me karton të kuq të një lojtari
- njofton përfundimin e pjesës së parë, përfundimin e ndeshjes ose të përfundimin e kohëve shtesë
 - qëndron në fushë, sic përshkruhet në kapitullin “Pozicioni në situatë kur topi nuk është në lojë”, i cili është pjesë e “Interpretimi i Rregullave të Lojës së Futsallës” (Neni 5 – Gjyqtarët), kur i kërkohet një gjë e tillë
- kryen detyrat e gjyqtarit të tretë kur ky mungon
- siguron çdo informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me lojën

[Ndeshjet ndërkombëtare](#)

Për ndeshjet ndërkombëtare prania e gjyqtarit të tretë dhe kohëmbajtësit është e detyruar.

Për ndeshjet ndërkombëtare, kohëmatësi (kronometri) i përdorur duhet të përmbajë të gjitha funksionët e nevojshme (kohëmatje të saktë, të jetë pajisur me mundësinë e matjes së 2 minutave për katër lojtarë njëkohësisht dhe tregues të faullave të akumuluar për çdo ekip në çdo pjesë lojë)

Rregulli 7 – KOHEZGJATJA E NDESHJES

Pjeset e lojes

Loja zgjat dy pjesë të barabarta prej 20 minutash, ose përndryshe sipas marrëveshjes së arritur midis gjyqtarëve dhe ekipeve. Çdo marrëveshje për të ndryshuar zgjatjen e pjesëve të lojës duhet bërë para fillimit të ndeshjes e duhet të jetë në përputhje me rregulloren e kompeticionit (garës)

Perfundimi i pjeseve te lojes

Kohëmatësi (kronometristi) njofton përfundimin e çdo pjese me sirenë ose bilbil. Pasi degjon sinjalin e kohëmatësit, një nga gjyqtarët deklaron përfundimin e pjesës ose të ndeshjes me fërshëllimën e bilbilit të vet, duke patur parasysh sa vijon:

- nëse duhet të kryhet goditja nga pika e dytë e penaltisë, ose goditje e lirë pas faullit të pestë të akumuluar, pjesa e lojës zgjatet deri sa të kryhet kjo goditje
- nëse duhet të kryhet goditja nga pika e penaltisë, pjesa e lojës zgjatet deri sa të kryhet kjo goditje

Nëse topi goditet drejt njerës prej portave përpara se kohëmatësi të ketë dhënë sinjalin e përfundimit, ose në të njëjtën kohë me atë sinjal, gjyqtarët duhet të presin që topi të përfundojë trajektoren. Pjesa përfundon kur:

- topi hyn drejtëpërdrejt në portë dhe shënohet gol
- topi del jashtë vijave kufizuese të fushës
- topi prek portierin mbrojtës, shtyllat e portës ose terrenin, kalon vijën e portës e është shënuar gol
- portieri mbrojtës pret topin ose ai përplaslet në shtyllë dhe nuk hyn në portë

Nëse gjatë trajektores së topit nuk ka patur shkelje të Rregullores që ndëshkohet me goditje të lirë pas faullit të pestë të akumuluar, ose penalti, pjesa përfundon kur:

- topi prek çdo lojtar veç portierit mbrojtës pasi ai është gjuajtur drejt portës kundërshtare

Pushimi nje minute (Time-out)

Ekipet kanë të drejtë për një pushim prej 1 minutë në çdo pjesë loje.

Kushtet e mëposhtme duhen plotësuar:

- zyrtarët e ekipit janë të autorizuar të kërkojnë pushimin të gjyqtari i tretë ose kohëmbajtësi kur nuk ka arbitër të tretë, duke përdorur dokumentin e caktuar
- kohëmbajtësi lajmeron pushimin 1 minutë, duke përdorur një sinjal akustik ndryshe nga ai që përdorin gjyqtarët, kur ekipi që e kërkon atë, do të rifillojë lojën pasi topi ka dale jashtë
- gjatë pushimit 1 minutë, lojtarët mund të qëndrojnë brenda ose jashtë fushës. Nëse duan të pijnë, lojtarët duhet të dalin jashtë fushës

- gjatë pushimit 1 minutë, lojtarët rezervë qëndrojnë jashtë fushës
- gjatë pushimit 1 minutë, drejtuesit e ekipit nuk mund të japin udhëzime brenda në fushë
- zëvendësimet kryhen sapo të jetë lajmeruar përfundimi i pushimit 1 minutë
- ekipi që nuk kërkon pushimin 1 minutë në pjesën e parë, ka të drejtën vetëm të një pushimi 1 minutë në pjesën e dytë
- nëse në një ndeshje nuk ka kohëmbajtës apo arbitër të tretë, zyrtarët e ekipeve mund t'ia kërkojnë pushimin 1 minutë gjyqtarëve
- nuk ka pushim 1 minutë në kohët shtesë, nëse luhen të tilla

Pushimi në gjysmën e kohës

Lojtarët kanë të drejtën e një pushimi në përfundim të pjesës së parë.

Ky pushim nuk duhet të zgjasë më shumë se 15 minuta.

Rregullorja e kompeticionit (garës) duhet të përcaktojë kohëzgjatjen e këtij pushimi. Kohëzgjatja e pushimit në përfundim të pjesës së parë mund të ndryshojë me pëlqimin e gjyqtarit.

Braktisja e ndeshjes

Një ndeshje që braktiset mund të riluhet, përveçse rasteve kur rregullorja e kompeticionit (garës) parashikon ndryshe.

Rregulli 8 – FILLIMI DHE RIFILLIMI I LOJES

Paraparakisht

Hidhet short me një monedhë dhe ekipi që fiton shortin vendos te zgjedhe se cilen portë do të sulmojë në pjesën e parë të ndeshjes ose kontrollin e goditjes nga qendra.

Në pjesën e dytë të ndeshjes, ekipet ndërrojnë gjysëmfishat dhe sulmojnë portat e kundërta.

Goditja nga qendra

Goditja nga qendra është një mënyrë për të filluar ose rifilluar lojën:

- në fillim të ndeshjes
- pas shënimit të një goli
- në fillim të pjesës së dytë
- në fillim të çdo pjesë shtesë, nëse ka

Nuk mund të shënohet gol drejtpërsedrejtë prej goditjes nga qendra.

Procedura (Menyra e kryerjes)

- të gjithë lojtarët duhet të rrinë në gjysëmfishën e tyre
- lojtarët e skuadres kundërshtarë qëndrojnë të paktën 3m larg nga topi deri sa ai të jetë në lojë
- topi qëndron palëvizur në pikën e qendrës së fushës
- gjyqtari jep sinjalin (shenjën)
- topi është në lojë kur goditet dhe leviz përpara

Pasi një ekip shënon gol, dhe nëse koha nuk ka përfunduar ende, goditja nga qendra kryhet prej ekipit tjetër.

Shkeljet dhe ndëshkimet

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që godet topin nga qendra e prek atë sërish

(përveç se me dorë) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- një goditje e lirë dykalimshe jepet për ekipin kundërshtar, që do kryhet në vendin ku ndodhej topi kur u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që godet topin nga qendra e prek atë me dorë në mënyrë të vullnetshme, përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- një goditje e lirë dykalimshe jepet për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhej topi kur u shkaktua shkelja (shih Neni 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar

Në rast të shkeljeve të tjera të procedurës së goditjes nga qendra:

- goditja nga qendra përsëritet dhe nuk mund të zbatohet përparësia (avantazhi)


Topi i diskutueshem

Nëse, ndërsa topi është në lojë, gjyqtarët duhet të ndërpresin lojën përkohësisht për arsye që nuk përmenden në Rregulloren e Lojës së Futsallës, ndeshja rifillon me top të disputueshëm. Ndeshja rifillon me top të disputueshëm edhe në rastet të cilat parashikohen në Rregulloren e Lojës së Futsallës.

Procedura

Gjyqtari ose gjyqtari i dytë e lëshon topin në vendin ku ndodhej kur u ndërpre loja, veç nëse ndodhej brenda zonës së penaltisë, gjyqtari e lëshon topin mbi vijën e zonës së penaltisë, në pikën më të afërt me atë ku ndodhej topi në çastin e ndërprerjes së lojës.

Loja rifillon kur topi prek fushën brenda vijave kufizuese. Nëse topi del nga fusha pasi është përplasur në tokë, pa u prekur nga ndonjë lojtar, topi do të ri-lëshohet në të njëjtën pikë që u lëshua herën e parë.



Shkeljet dhe ndëshkimet

Topi lëshohet sërish në të njëjtin vend ku u lëshua herën e parë:

- nëse preket nga një lojtar pa prekur më parë fushën
- nëse është kryer ndonjë shkelje tjetër përpara se topi të prejë fushën

Rregulli 9 – TOPI NE LOJE DHE JASHTË LOJE

Topi jashtë loje

Topi është jashtë loje kur:

- ka kapërcyer plotësisht vijën fundore ose anësore, në tokë ose në ajër
- loja është ndaluar prej gjyqtarëve
- godet tavanin ose mbulesën e sipërme

Topi ne loje

Topi është në lojë gjatë gjithë kohën tjetër, përfshirë edhe kur:

- rikthehet në fushë pasi përplasët në shtyllat e portës
- përplasët me një nga gjyqtarët kur ata ndodhen në fushë

Fusha te mbyllura (mbuluara)

Lartësia me e vogël e tavanit është 4m dhe shpjegohet në rregulloren e garës. Nëse topi godet tavanin gjatë lojës, loja rifillon me rivënie anësore për ekipin kundërshtar. Rivënia anësore kryhet mbi vijën anësore, në pikën me të afërt me vendin ku topi preku tavanin. (shih Rregulli 5 – Pozicioni i rivënies anësore).

Rregulli 10 – MENYRA E SHENIMIT TE GOLIT

Shenimi i golit

Shënohet gol kur gjithë perimetri i topit ka kaluar mbi vijën fundore, midis dy shtyllave pingule dhe traut të portës, dhe nuk ka patur shkelje të Rregullave të Lojës së Futsallës nga ekipi që shënon.

Goli anulohet nëse portieri i ekipit sulmues e hedh ose godet topin qëllimisht me dorë prej zonës së vet të penalltisë dhe është lojtari i fundit që e ka prekur atë. Loja rifillon me rivënie fundore për ekipin kundërshtar.

Nëse, pasi shënohet gol, përpara rifillimit të lojës, gjyqtarët kuptojnë që ekipi që shënoi golin luante me një lojtar me shumë ose kreu një zëvendësim të gabuar, atëherë ata duhet ta anulojnë golin dhe të rifillojnë lojën me goditje të lirë dykalimshe, në favor dhe brenda zonës së penalltisë së ekipit që pesoi gol. Nëse goditja nga qendra është kryer, gjyqtarët ndëshkojnë lojtarin që kreu shkeljen në përputhje me Rregullin 3, por goli do të quhet i rregullt. Gjyqtarët duhet ta shkruajnë këtë fakt në protokollin e ndeshjes. Nëse goli shënohet nga ekipi tjetër, atëherë ata duhet ta quajnë të rregullt.

Ekipi fitues

Ekipi që shënon numrin më të madh të golave në një ndeshje, është fitues i asaj ndeshje. Nëse të dy ekipet shënojnë numër të barabartë golash, ose nuk shënojnë asnjë gol, atëherë ndeshja quhet barazim.

Rregullorja e gares

Kur rregullorja e garës përcakton që duhet të ketë një ekip fitues pas një ndeshje ose takime vajtje-ardhje, vetëm kushtet e mëposhtme duhet të merren parasysh në përcaktimin e fituesit:

- golat e shënuar në fushën kundërshtare
- koha shtesë
- goditjet nga pika e penalltisë

Goditjet nga pika e penalltise (6metra)

Procedura

- Goditjet nga pika e penalltisë nuk janë pjesë e ndeshjes
- Krahu në të cilin kryhen goditjet nga pika e penalltisë mund të ndryshohet vetëm në rast se demtohet porta ose fusha (terreni) bëhet i papërdorshëm ose për arsye sigurie
- Pasi të gjithë lojtarët e zgjedhur kanë kryer goditjen e tyre nga pika e penalltisë, nuk është e domosdoshme të ndiqët e njëjta rradhe në goditjen e penalltive shtesë
- Çdo ekip është përgjegjes të caktojë lojtarët që do të kryejnë goditjet nga pika e penalltisë, prej lojtarëve e zevendesuesve si edhe rradhen që do të ndjekin në kryerjen e tyre, e duhet të njoftojnë gjyqtarin e tretë përpara se të fillojë kryerja e penalltive
- Me përjashtim të portierit, pasi ka filluar kryerja e penalltive, një lojtar që lëndohet nuk mund të zëvendësohet
- Nëse portieri ndëshkohet me karton të kuq gjatë kryerjes se penalltive, ai mund të zëvendësohet nga një lojtar tjetër që është duke kryer penalltitë, por jo nga një portier tjetër në rast se ky I fundit ishte përjashtuar nga kryerja e penalltive
- Një lojtar ose zevendesues mund të ndëshkohen me karton të verdhë ose të kuq gjatë kryerjes se penalltive
- Gjyqtarët nuk duhet të braktisin kryerjen e penalltive nëse një ekip mbetet me më pak se tre lojtarë gjatë kryerje së penalltive
- Nëse një lojtar lëndohet ose ndëshkohet me karton të kuq gjatë kryerjes se penalltive dhe ekipi i tij mbetet me një lojtar me pak, ekipi kundërshtar nuk pakeson numrin e lojtarëve
- Numri I barabartë i lojtarëve për të dy ekipet kërkohet vetëm në fillim të kryerjes se goditjeve nga pika e penalltisë
- Nëse topi shpohet ose demtohet pasi godet një nga shtyllat ose traun e portës dhe hyn në portë, goli quhet i rregullt
- Nëse topi shpohet ose demtohet pasi godet një nga shtyllat ose traun e portës dhe nuk hyn në portë, gjyqtarët nuk urdhërojnë përsëritjen e penalltisë pasi ajo konsiderohet të jetë kryer
- Nëse rregullorja e garës përcakton që duhen kryer goditjet nga pika e penalltisë për të përcaktuar fituesin në sistemin vajtje-ardhje dhe ekipet refuzojnë, gjyqtarët raportojnë të autoritetet përkatëse të garës
- Nëse, përpara fillimit të goditjeve nga pika e penalltisë, një ose me shumë lojtarë të zgjedhur largohen nga fusha ose refuzojnë të kryejnë penalltitë dhe nuk janë të lënduar, gjyqtarët braktisin kryerjen e penalltive dhe njoftojnë autoritetet përkatëse të garës
- Gjatë kryerjes se goditjeve nga pika e penalltisë, gjyqtarët nuk lejojnë kamera ose media të tjera në fushë

Rregulli 11 – POZICIONI JASHTË LOJE

Nuk ka pozicion jashtë loje në futsallë.

Rregulli 12 – FAULLAT DHE SJELLJET E PAHIJSHME

Faullat dhe sjelljet e pahijshme janë shkelje të Rregullores së Lojës së Futsallës që ndëshkohen si vijon:

Faullat

Faullat ndëshkohen me goditje të lirë direkte, penallti ose goditje të lirë dykalimshe.

Faullat që ndëshkohen me goditje të lirë direkte

Goditja e lirë direkte jepet në favor të ekipit kundërshtar nëse një lojtar kryen një nga shtatë shkeljet e mëposhtme, në mënyrë të tillë që nga gjyqtarët konsiderohet të jetë e pakujdeseshme, e pamatur ose me force të tëpruar:

- shkelmon ose përpiqet të shkelmoje kundërshtarin
 - rrezon kundërshtarin
 - hidhet mbi kundërshtarin
 - pengon kundërshtarin
 - godet ose përpiqet të godase kundërshtarin
 - shtyn kundërshtarin
 - nderhyn ndaj kundërshtarit (duke patur kontakt me parë me të se sa me topin)
- Goditje e lirë direkte jepet gjithashtu në favor të ekipit kundërshtar nëse një lojtar kreyt një nga shkeljet e mëposhtme:
- mban kundërshtarin (psh e tërheq nga fanella)
 - pështyn kundërshtarin
 - prek topin me dorë qëllimisht (përveç portierit brenda zonës së vet të penalltisë)
- Goditja e lirë direkte kryhet prej vendit ku ndodhet topi në çastin e shkeljes së Rregullores (shih Neni 13 – Pozicioni i goditjes së lirë).

Shkeljet e mësipërme janë faulla të akumuluar (të shtuar; të mbledhshme).

Faullat që ndëshkohen me penallti

Penalltia jepet në favor të ekipit kundërshtar nëse një nga shkeljet e mësipërme shkaktohet nga një lojtar brenda zonës së vet të penalltisë, pavarësisht pozicionit të

topit në fushë, mjaft që ai të jetë në lojë.

Faultat që ndeshkohen me goditje të lirë dykalimshe (indirekte)

Goditja e lirë dykalimshe jepet në favor të ekipit kundërshtar nëse portieri kryen një nga katër shkeljet e mëposhtme:

- zotëron topin me dorë ose me këmbë në gjysëmfushën e tij me shumë se katër sekonda
- pasi e lëshon topin nga zotërimi, ai e prek atë sërish në gjysëmfushën e tij pasi i është pasuar qëllimisht nga një shok i ekipit, pa u prekur me parë prej kundërshtarit
- prek topin me dorë brenda zonës së tij të penaltisë pasi i është pasuar qëllimisht nga një shok i ekipit
- prek topin me dorë brenda zonës së tij të penaltisë pasi e ka marrë prej një shoku të ekipit drejtëpërdrejt nga rivënia anësore

Goditja e lirë dykalimshe jepet në favor të ekipit kundërshtar edhe kur, në gjykimin e gjyqtarëve, një lojtar:

- luan në mënyrë të rrezikshme kur ka kundërshtarin pranë (psh ngritja e takave pa prekur kundërshtarin)
- pengon përparimin e kundërshtarit
- pengon portierin të lëshojë topin nga duart
- kryen ndaj shokeve të tij të ekipit, një nga nentë shkeljet që ndeshkohen me goditje të lirë direkte nëse do të kryheshin ndaj kundërshtarit
- kryen çdo shkelje tjetër që nuk është përmendur më parë në Nenin 12 ose në ndonjë Nen tjetër, dhe që loja ndalet për të ndëshkuar me karton një lojtar

Goditja e lirë dykalimshe kryhet prej vendit ku ndodhej topi në çastin e shkeljes së Rregullores (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Sjelljet e pahijshme

Sjellja e pahijshme ndëshkohet me paralajmërim (karton i verdhë) ose nxjerrje jashtë (karton i kuq).

Masat ndeshkimore (disiplinore)

Kartoni i verdhë përdoret për të treguar që një lojtar apo rezervë është paralajmëruar.

Kartoni i kuq përdoret për të treguar që një lojtar apo rezervë është nxjerrë jashtë nga loja.

Kartonat u tregohen vetëm lojtarëve ose rezervave. Kartonat tregohen hapur që të mund t'i shohin të gjithë dhe vetëm brenda fushës pasi ka nisur ndeshja. Në rastet e tjera, gjyqtarët njoftojnë gojarisht lojtarët dhe zyrtarët e ekipeve për masat ndëshkuese të ndërmarra.

Gjyqtarët kanë autoritetin të marrin masa ndëshkimore prej çastit që hyjnë në ndërtesën ku ndodhet fusha përpara ndeshjes deri sa largohen prej saj.

Një lojtar që kryen një shkelje të dënueshme me karton të verdhë ose të kuq, brenda apo jashtë fushës, ndaj kundërshtarëve, shokeve të tij, gjyqtarëve apo çdo personi tjetër, ndëshkohet sipas natyres së shkeljes së kryer.

Shkeljet paralajmëruese

Një lojtar paralajmërohet (karton i verdhë) nëse kryen një nga shtatë shkeljet e mëposhtme:

- sjellje jo sportive
- kundërshtim (protestë) me fjalë ose me gjeste (veprime)
- shkel në mënyrë të përsëritur Rregulloren e Lojës së Futsallës
- vonon rifillimin e lojës
- nuk zbaton largësinë (distancën) e kerkuar gjatë goditjes nga këndi, goditjes së lirë ose rënies anësore (lojtari mbrojtës)
- hyn ose ri-hyn në fushë pa lejen e gjyqtarëve ose shkel rregullin e zëvendësimit
- largohet qëllimisht nga fusha pa lejen e gjyqtarit

Një rezervë paralajmërohet nëse kryen një nga katër shkeljet e mëposhtme:

- sjellje jo sportive
- kundërshtim me fjalë ose gjeste (veprime)
- vonon rifillimin e lojës

- hyn në fushë duke shkelur rregullin e zëvendësimit

Ndeshkimet me karton të kuq

Një lojtar ose rezervë nxirret jashtë (me karton të kuq) nëse kryen një nga shtatë shkeljet e mëposhtme:

- faull të rende
- sjellje të dhunëshme
- pështyn kundërshtarin ose çdo person tjetër
- i mohon ekipit kundërshtar shënimin e një goli të sigurt duke e prekur topin me dorë qëllimisht (përveç portierit në zonën e tij të penalltisë)
- i mohon shënimin e një goli të sigurt një kundërshtari duke shkaktuar një shkelje që ndëshkohet me goditje të lirë ose penallti
- përdor fjalor ose gjeste fyese, vulgar ose abusive
- merr kartonin e dytë të verdhë në të njëjtën ndeshje

Një rezervë nxirret jashtë nëse kryen shkeljen e mëposhtme:

- i mohon kundërshtarit shënimin e një goli të sigurt

Një lojtar ose rezervë që nxirret jashtë nuk mund të qëndrojë pranë fushës dhe as në zonën teknike.

Rregulli 13 – GODITJET E LIRA

Lloji i goditjeve te lira

Goditjet e lira janë direkte (drejtpërdrejta) ose dykalimshe (indirekte).

Goditjet e lira direkte

Sinjali

Një nga gjyqtarët sinjalizon goditjen e lirë direkte duke mbajtur një krah horizontalisht në drejtimin që do të kryhet goditja e lirë. Me dorën tjetër gjyqtari tregon fushën duke e bërë të qartë për gjyqtarin tjetër dhe kohëmbajtësin që ky është faull i akumuluar

Topi hyn në portë

- nëse topi nga goditja e lirë direkte hyn drejtëpërdrejt në portën kundërshtare, goli quhet i vlefshëm
- nëse topi nga goditja e lirë direkte hyn drejtëpërdrejt në portën e ekipit që e kryen atë, atëherë jepet goditje nga këndi për ekipin kundërshtar

Faulla të akumuluar

- janë ata faulla që ndëshkohen me goditje të lirë direkte ose me penallti sic përmenden në Rregullin 12
- faullat e akumuluar të shkaktuar nga çdo ekip në çdo pjesë lojë shenohen në protokollin e ndeshjes
- gjyqtarët mund të lejojnë lojën të vazhdojë duke zbatuar përparësinë (avantazhin) nëse ekipi nuk ka plotësuar me parë pesë faulla të akumuluar dhe ekipit kundërshtar nuk i mohohet një gol ose rast i pastër shënimi
- nëse zbatojnë përparësinë (avantazhin), gjyqtarët japin sinjalin e detyruar për të

treguar faullin e akumuluar kohëmbajtësit dhe gjyqtarit të tretë, sapo topi nuk është me në lojë

- nëse luhet kohë shtesë, faullat e akumuluar në pjesën e dytë mbartën në kohën shtesë.

[Goditjet e lira indirekte dykalimeshe](#)

Sinjali

Gjyqtarët sinjalizojnë goditjen e lirë indirekte duke ngritur njërin krah vertikalisht. E mbajnë krahun në atë pozicion deri sa të jetë kryer goditja e topit dhe ai të ketë prekur një lojtar ose të ketë përfunduar jashtë.

Topi hyn në portë

Mund të shënohet gol vetëm nëse topi prek një lojtar tjetër përpara se të hyjë në portë:

- nëse goditja e lirë indirekte gjuhet drejtëpërdrejt në portën kundërshtare, atëherë jepet rivënie fundore
- nëse goditja e lirë indirekte gjuhet drejtëpërdrejt në portën e vet, atëherë jepet goditje nga këndi për ekipin kundërshtar

[Procedura](#)

Si në goditjen direkte edhe atë indirekte, topi duhet të të qëndroje pa levizur kur kryhet goditja.

Goditja e lirë direkte duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar për çdo ekip:

- Lojtari që kryen goditjen duhet të godase topin me qëllim për të shënuar gol dhe nuk mund t'ia pasojë topin një shoku të ekipit
- Pasi kryhet goditja, askush nga lojtarët nuk mund ta prekë topin, deri sa ai të jetë preku prej portierit kundërshtar, të përplasët në shtyllë ose në traun e portës, ose të ketë dale jashtë fushës
- Nëse një lojtar shkakton faullin e gjashtë të akumuluar në gjysëm-fushën kundërshtare ose në gjysëm-fushën e vet, por jo në zonën midis pikës së dytë të penalltisë dhe vijës fundore, atëherë goditja kryhet nga pika e dytë e penalltisë. Vend ndodhja e pikës së dytë të penalltisë tregohet në Nenin 1. Goditja e lirë kryhet në përputhje me kapitullin e titulluar "Pozicioni i goditjes së lirë"
- Nëse një lojtar shkakton faullin e gjashtë të akumuluar në dem të ekipit të tij,

në gjysëmfishën e vet dhe midis pikës së dytë të penalltisë 10m dhe vijës fundore, por jashtë zonës së penalltisë 6m, ekipi sulmues zgjedh se ku do ta vendosë topin, ose në pikën e dytë të penalltisë ose në vendin ku u shkaktua faulli

- Duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar, nëse ka përfunduar koha e çdo pjesë dhe kohës shtesë, atëherë zgjatet koha vetëm për t'u kryer goditja e lirë


[Pozicioni i goditjes së lirë](#)

Goditja e lirë jashtë zonës së penalltisë (6m)

- Të gjithë lojtarët kundërshtarë duhet të jenë të paktën 5m larg topit deri sa ai të jetë në lojë
- Topi është në lojë kur goditet dhe leviz
- Goditja e lirë kryhet prej vendit ku u shkaktua faulli, ose prej vendit ku ndodhej topi në momentin e shkaktimit të faullit (sipas llojit të shkeljes) ose prej pikës së dytë të penalltisë 10m

Goditjet e lira direkte ose indirekte brenda zonës së penalltisë 6m të ekipit mbrojtës

- Të gjithë lojtarët kundërshtarë duhet të jenë të paktën 5m larg topit deri sa ai të jetë në lojë
- Të gjithë lojtarët kundërshtarë qëndrojnë jashtë zonës së penalltisë 6m deri sa topi të jetë në lojë
- Topi është në lojë kur goditet drejtëpërdrejt jashtë zonës së penalltisë 6m
- Goditja e lirë brenda zonës së penalltisë mund të kryhet kudo brenda kësaj zone



Shkeljet dhe ndeshkimet

Nëse, kur kryhet një goditje e lirë, një kundërshtar ndodhet me afër topit se largësia e lejuar:

- Lojtari që kryen shkeljen ndëshkohet me karton të verdhë dhe goditja e lirë përsëritet, veç nëse mund të zbatohet përparësia (avantazhi) ose është kryer një shkelje tjetër e ndeshkueshme me penallti. Nëse shkelja është e ndeshkueshme me goditje të lirë, gjyqtarët vendosin nëse do të ndëshkojnë shkeljen e parë apo të dytën. Nëse shkelja e dytë ndëshkohet me penallti ose goditje të lirë direkte, atëherë një faull i akumuluar regjistrohet ndaj ekipit që shkaktoi faullin

Nëse, kur kryhet goditja e lirë prej ekipit mbrojtës në zonën e vet të penalltisë 6m, topi nuk goditet drejtpërdrejt jashtë zonës së penalltisë:

- Goditja përsëritet

Nëse ekipi që kryen goditjen e lirë vonon me shumë se katër sekonda:

- Gjyqtarët japin një goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku do të rifillontë loja (shoh Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar, nëse lojtari që kryen goditjen nuk ka për qëllim të shenojë gol:

- Gjyqtarët japin një goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku do të rifillontë loja

Duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar, nëse goditja kryhet nga një lojtar tjetër i ekipit dhe jo ai i përcaktuar me parë:

- Gjyqtarët ndalojnë lojën, e ndëshkojnë lojtarin me karton të verdhë për sjellje të pahijshme dhe e rifillojnë lojën me goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar në vendin ku ai lojtar goditi topin

Goditja e lirë që kryhet nga një lojtar dhe jo nga portieri

Nëse, pasi topi është në lojë, lojtari që goditi topin e prek atë sërish (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- Goditje e lirë indirekte jepet për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Nëse, pasi topi është në lojë, lojtari që goditi topin e prek atë qëllimisht me dorë përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- Goditje e lirë direkte jepet për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë) dhe ekipi ndëshkohet me një faull të akumuluar
- Penallti në favor të ekipit kundërshtar nëse topi u prek me dorë brenda zonës se penalltisë 6m se lojtarit që goditi topin, dhe ekipi ndëshkohet me një faull të akumuluar

Goditja e lirë kryer nga portieri

Nëse, pasi topi është në lojë, portieri e prek atë sërish (përveçse me duar), përpara se topi të prekë një lojtar tjetër:

- Goditje e lirë indirekte jepet për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Nëse, pasi topi është në lojë, portieri e prek qëllimisht topin me dorë përpara se ai të jetë prekur nga një lojtar tjetër:

- goditje e lirë direkte jepet për ekipin kundërshtar nëse shkelja u shkaktua jashtë zonës se penalltisë se portierit, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë) dhe ekipi i tij do të ndëshkohet me një faull të akumuluar
- goditje e lirë indirekte jepet për ekipin kundërshtar nëse shkelja u shkaktua brenda zonës se penalltisë se portierit, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Nëse gjyqtarët japin shenjën për të kryer goditjen e lirë direkte, duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar, dhe përpara se topi të jetë në lojë:

Një lojtar i ekipit që do të kryejë goditjen shkel Rregulloren e Lojës se Futsallës, përveçse kur lojtari që do të kryejë goditjen vonon me shumë se katër sekonda:

- gjyqtarët lejojnë që të kryhet goditja
- nëse topi hyn në portë, goditja përsëritet
- nëse topi nuk hyn në portë, gjyqtarët ndalojnë lojën dhe urdhërojnë që loja të rifillojë me goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Një lojtar i ekipit mbrojtës shkel Rregulloren e Lojës së Futsallës:

- gjyqtarët lejojnë goditjen të kryhet
- nëse topi hyn në portë, goli është i vlefshëm
- nëse topi nuk hyn në portë, goditja përsëritet

Një ose më shumë lojtarë të të dy ekipeve shkelin Rregulloren e Lojës së Futsallës në njëjtën kohë:

- goditja përsëritet

Duke filluar me faullin e gjashtë të akumuluar, pasi goditja e lirë është kryer:

Lojtari nuk e godet topin përpara në drejtim të portës me qëllim për të shënuar gol:

- gjyqtarët ndalojnë lojën dhe urdhërojnë rifillimin e lojës me goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Lojtari që kryen goditjen e prek sërisht topin (përveçse me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- goditje e lirë indirekte jepet për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Një lojtar tjetër i ekipit që kryen goditjen e prek topin (përveçse me duar), përpara se topi të ketë prekur portierin mbrojtës, të jetë rikthyer në fushë pas përplasjes në shtyllë ose traun e portës ose del jashtë:

- goditje e lirë indirekte jepet për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Një lojtar e prek topin me dorë qëllimisht:

- goditje e lirë direkte jepet për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku u shkaktua shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar
- penalti jepet nëse topi preket me dorë nga një mbrojtës në zonën e vet të penaltisë 6m, përveç portierit (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar topi preket nga një agjent i jashtëm dhe leviz përpara
- goditja përsëritet

Topi rikthehet në fushë pasi përplasët të portieri, shtyllat ose trau i portës dhe preket nga një agjent i jashtëm:

- gjyqtarët ndalojnë ndeshjen
- loja rifillon me një top të disputueshëm në vendin ku u prek nga agjenti i jashtëm, veç rastit nëse prekja u krye brenda zonës së penaltisë 6m, në këtë rast gjyqtari e lëshon topin mbi vijën e zonës së penaltisë në pikën më të afërt me vendin ku u prek topi

Topi shpohet ose difektohet kur është në lojë por pa prekur me parë shtyllat ose traun ose ndonjë lojtar tjetër:

- goditja përsëritet

Rregulli 14 – PENALLTIA

Penalltia jepet kundër një ekipi që shkakton një nga dhjetë shkeljet që ndëshkohen me goditje të lirë direkte, brenda zonës së vet të penaltisë 6m, ndërsa topi është në lojë.

Mund të shënohet gol drejtpërdrejt nga penalltia.

Në rast se koha ka mbaruar, në fund të çdo pjesë ose të kohëve shtesë, gjyqtarët e zgjasin kohën që të kryhet goditja e penaltisë

Pozicioni i topit dhe lojtareve

Topi:

- duhet të vendoset mbi pikën e penaltisë

Lojtari që do kryejë goditjen:

- identifikohet qartësisht

Portieri mbrojtës:

- duhet të qëndroje mbi vijën e portës, midis shtyllave pingule, me fytyrë nga lojtari që godet topin, deri sa topi të jetë goditur

Lojtarët e tjerë, veç atij që kryen goditjen, duhet të qëndrojnë:

- në fushë
- jashtë zonës së penalltisë
- prapa pikës së penalltisë
- të paktën 5m larg pikës së penalltisë

Procedura e penaltisë

- Pasi lojtarët zenë vendet në përputhje me këtë Nen, një nga gjyqtarët sinjalizon që të kryhet goditja e penalltisë
- Lojtari që kryen goditjen duhet ta godase topin përpara
- Topi është në lojë kur goditet e leviz përpara

Kur penalltia jepet gjatë rrjedhës normale të lojës, ose koha është zgjatur në fund të çdo pjesë ose të kohëve shtesë, për të lejuar kryerjen e penalltisë, goli quhet i vlefshëm nëse, përpara se të kalojë vijën e portës midis shtyllave pingule dhe traut:

- Topi prek shtyllat pingule dhe/ose traun dhe/ose portierin

Shkeljet dhe ndeshkimet

Nëse lojtari që godet topin nga pika e penalltisë, nuk e godet atë drejt portës:

- gjyqtarët ndalojnë lojën dhe urdhërojnë që loja të rifillojë me goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet nga pika e penalltisë (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse, ndërkohë që do të kryhet penalltia, topi goditet nga një shok i ekipit të lojtarit që ishte paracaktuar :

- gjyqtarët ndalojnë lojën, e ndëshkojnë atë me karton të verdhë për sjellje të pahijshme dhe urdhërojnë rifillimin e lojës me goditje të lirë indirekte, që do të kryhet nga pika e penalltisë (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse gjyqtarët bëjnë shenjë që të kryhet penalltia dhe, përpara se topi të jetë në lojë, ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme:

Një lojtar i të njëjtit ekip me lojtarin që do të kryejë penalltinë shkel Rregulloren e

Lojës së Futsallës:

- gjyqtarët lejojnë goditjen e topit
- nëse topi hyn në portë, goditja përsëritet
- nëse topi nuk hyn në portë, gjyqtarët ndalojnë lojën dhe urdhërojnë që loja të rifillojë me goditje të lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet atje ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

një lojtar i ekipit mbrojtës shkel Rregulloren e Lojës së Futsallës:

- gjyqtarët lejojnë goditjen e topit
- nëse topi hyn në portë, goli është i vlefshëm
- nëse topi nuk hyn në portë, goditja përsëritet

një ose më shumë lojtarë të të dy ekipeve shkelin Rregulloren e Lojës së Futsallës në të njëjtën kohë:

- goditja përsëritet

Nëse, pasi është kryer penalltia:

Lojtari që goditi topin e prek atë sërish (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

lojtari që kryen penalltinë prek topin me dorë përpara se ai të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar, të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar

topi preket nga një agjent i jashtëm dhe leviz përpara:

- goditja përsëritet

topi rikthehet në fushë pasi përplasët te portieri, shtyllat ose trau i portës dhe preket nga një agjent i jashtëm:

- gjyqtarët ndalojnë ndeshjen
- loja rifillon me një top të disputueshëm në vendin ku u prek nga agjenti i jashtëm, veç rastit nëse prekja u krye brenda zonës së penalltisë 6m, në këtë rast gjyqtari e lëshon topin mbi vijën e zonës së penalltisë në pikën më të afërt me vendin ku

u prek topi

topi shpohet ose difektohet kur është në lojë por pa prekur me parë shtyllat ose traun ose ndonjë lojtar tjetër:

- goditja përsëritet

Rregulli 15 – RIVENJA ANESORE

Rivënia anësore është një mënyrë për të rifilluar lojën.

Rivënia anësore i jepet ekipit kundërshtar të lojtarit që preku topin për herë të fundit, kur gjithë perimetri i topit kapërcen plotësisht vijën anësore, në tokë ose në ajër, ose prek tavanin e salles.

Nuk mund të shënohet gol drejtëpërdrejt nga rivënia anësore.

Pozicioni i lojtareve

Kundërshtaret duhet të qëndrojnë:

- në fushë
- një një largesi jo me pak se 5m nga vija anësore ku do të kryhet rivënia anësore

Procedura

Ka vetëm një lloj procedure:

- rivënie e topit në lojë nga vija anësore

Pozicioni i rivënies anësore

Në momentin e goditjes së topit, lojtari:

- ka njëren këmbë mbi vijën anësore ose jashtë fushës
- shkelmon topin, i cili duhet të qëndroje pa levizur, ose mbi vijën anësore në pikën që doli jashtë, ose jashtë fushës në një largesi jo me shumë se 25cm prej vijës anësore
- e shkelmon topin brenda katër sekondave kur është gati për ta kryer rivënien

Topi është në lojë kur hyn në fushë.

Shkeljet dhe ndëshkimet

Nëse, kur kryhet rivënia anësore, një kundërshtar ndodhet më afër topit se largësia e lejuar:

- rivënia anësore përsëritet, përveç rasteve kur mund të zbatohet përparësia ose shkelja e kryer është e ndeshkueshme me goditje të lirë ose penallti dhe lojtari që kreu shkeljen ndëshkohet me karton të verdhë

Nëse një kundërshtar qëllimisht pengon lojtarin që do të kryejë rivënien anësore:

- ai ndëshkohet me karton të verdhë për sjellje të pahijshme

Për çdo shkelje tjetër të procedurës së rivënies anësore:

- rivënia do të kryhet nga ekipi kundërshtar

Rivënia anësore prej një lojtari veç portierit

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që kreu rivënien e prek sërish atë (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që kryen rivënien e prek qëllimisht topin me dorë përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar.
- jepet penallti për ekipin kundërshtar nëse prekja e topit me dorë ndodhi brenda zonës së penalltisë së lojtarit që kreu rivënien anësore dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar

Rivënia anësore që kryhet nga portieri

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek sërish topin (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek topin me dorë qëllimisht përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodhi jashtë zonës së penalltisë së portierit, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar
- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodh brenda zonës së penalltisë së portierit, që do të kryhet mbi vijën e zonës në pikën më të afërt me vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Rregulli 16 – RIVENJA FUNDORE

Rivënia fundore është një mënyrë e rifillimit të lojës.

Rivënia fundore jepet kur gjithë perimetri i topit kapërcen mbi vijën fundore, në tokë ose në ajër, dhe është prekur për herë të fundit nga një lojtar i ekipit sulmues dhe nuk është shënuar gol sipas Rregullit 10.

Nuk mund të shënohet gol drejtëpërdrejt nga rivënia fundore.

Procedura

Kundërshtaret duhet të qëndrojnë:

- në fushë dhe jashtë zonës se penaltisë 6m të ekipit që do të kryejë rivënien fundore, deri sa topi të jetë në lojë
- Topi hidhet me dorë nga portieri i ekipit mbrojtës që ndodhet brenda zonës së tij të penaltisë
- Portieri i ekipit mbrojtës e kryen rivënien fundore brenda katër sekondave kur është gati ta kryejë atë
- Topi është në lojë kur hidhet drejtëpërdrejt jashtë zonës se penaltisë 6m prej portierit të ekipit mbrojtës

Shkeljet dhe ndeshkimet

Nëse nga rivënia fundore, topi nuk hidhet drejtëpërdrejt jashtë zonës se penaltisë 6m:

- Rivënia përsëritet, por numërimi i katër sekondave nuk fillon nga e para por vazhdon kur portieri është gati për rivënien

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek sërish atë (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një kundërshtar (veçse kur ka prekur aksidentalisht një lojtar të ekipit të tij):

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek atë qëllimisht me dorë, përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodhi jashtë zonës së penalltisë 6m të portierit, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja
(shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar
- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodhi brenda zonës së penalltisë 6m të portierit, që do të kryhet mbi vijën e zonës në pikën më të afërt me vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse rivënia fundore nuk kryhet brenda katër sekondave:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet mbi vijën e zonës në pikën më të afërt me vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes së lirë)

Nëse rivënia fundore kryhet ndërsa lojtarët kundërshtarë ndodhen brenda zonës së penalltisë 6m:

- rivënia përsëritet vetëm nëse topi prek një nga kundërshtarët ose ata pengojnë portierin të kryejë rivënien

Për çdo shkelje tjetër të këtij Neni:

- Rivënia fundore përsëritet. Nëse shkelja kryhet nga ekipi që ben rivënien, numërimi i katër sekondave nuk fillon nga e para por vazhdon kur portieri është gati të kryej rivënien.

Rregulli 17 – GODITJA NGA KENDI

Goditja nga këndi është një mënyrë e rifillimit të lojës.

Goditja nga këndi jepet kur gjithë perimetri i topit ka kapërcyer mbi vijën fundore, në tokë ose në ajër, dhe ka prekur për herë të fundit një lojtar të ekipit mbrojtës dhe nuk është shënuar gol sipas Rregullit 10.

Mund të shënohet gol drejtëpërdrejt nga goditja e këndit, por vetëm në portën kundërshtare.

Procedura

Topi vendoset:

- brenda harkut këndor me të afërt me pikën ku topi kapërceu vijën fundore

Lojtarët kundërshtare qëndrojnë:

- në fushë të paktën 5m larg harkut këndor deri sa topi të jetë në lojë
- Topi duhet të shkëlmohet nga një lojtar i ekipit sulmues
- Ekipi që kryen goditjen duhet ta bëjë këtë brenda katër sekondave kur është gati për këtë
- Topi është në lojë kur shkëlmohet dhe leviz

Shkeljet dhe ndeshkimet

Nëse, kur kryhet goditja nga këndi, një kundërshtar është me afër topit se largësia e lejuar:

- Goditja këndore përsëritet përveç sekur zbatohet përparësia ose shkelja ndëshkohet me goditje të lirë direkte ose penalti, dhe lojtari që kreu shkeljen ndëshkohet me karton të verdhë

Nëse një kundërshtar pengon qëllimisht lojtarin që do të shkëlmojë goditjen këndore:

- ai ndëshkohet me karton të verdhë për sjellje të pahijshme

Nëse goditja këndore nuk kryhet brenda katër sekondave:

- jepet rivënie fundore për ekipin kundërshtar

Për çdo shkelje tjetër të procedures ose të pozicionit të topit:

- goditja këndore përsëritet. Nëse shkelja kryhet nga ekipi sulmues, numërimi i katër sekondave nuk fillon nga e para por vazhdon kur lojtari që kryen goditjen është gati për të

Goditja këndore nga një lojtar përveç portierit

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që kreu goditjen e prek sërish topin (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Nëse topi është në lojë dhe lojtari që kryen goditjen e prek qëllimisht topin me dorë përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar
- jepet penallti 6m, për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodhi brenda zonës se penalltisë se lojtarit që kreu goditjen këndore dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar

Goditja këndore që kryhet nga portieri

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek atë sërish (përveç se me duar) përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja (shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

Nëse topi është në lojë dhe portieri e prek atë me dorë qëllimisht përpara se topi të ketë prekur një lojtar tjetër:

- jepet goditje e lirë direkte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodhi jashtë zonës se penalltisë 6m të portierit, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja
(shih Rregulli 13 - Pozicioni i goditjes se lirë) dhe ekipi i tij ndëshkohet me një faull të akumuluar
- jepet goditje e lirë indirekte për ekipin kundërshtar nëse shkelja ndodh brenda zonës se penalltisë 6m të portierit, që do të kryhet në vendin ku ndodhi shkelja
(shih Rregulli 13 – Pozicioni i goditjes se lirë)

FUTSAL

RREGULLAT E LOJES

2020/21

**GUIDE PRAKTIKE PER GJYQTARET E FUTSAL DHE ZYRTARET E
TJERE TE NDESHJES**

SINJALIZIMI

POZICIONIMI

INTERPRETIME DHE REKOMANDIME

Sinjalizimet

Arbitrat duhet të japin sinjalet e renditura më poshtë, duke pasur parasysh se shumica e sinjaleve duhet të bëhen vetëm nga njëri prej gjyqtarëve. Por disa sinjale duhet të jepen nga të dy gjyqtarët në të njëjtën kohë.

Ndihmësit e gjyqtarëve duhet të japin sinjalet për një timeout dhe faullin e pestë të akumuluar.

1 Signals by at least one of the referees



Kick-off/restart of play



Direct free kick/penalty kick (Option 1)



(Option 2)



Kick-in (Option 1)



(Option 2)



Corner kick (Option 1)



(Option 2)



Goal clearance (Option 1)



(Option 2)

FOUR-SECOND COUNT



(Step I)



(Step II)



(Step III)



(Step IV)



(Step V)

Të paktën një nga gjyqtarët duhet të tregojë qartë numërimin e katër sekondave:

- në rinisjet e mëposhtme:

- goditje këndi;
- rivenje fundore;
- rivenie anesore;
- goditje të lira direkte ose indirekte

- kur portieri kontrollon topin në gjysmën e tij / saj të fushës.

Arbitrat nuk llogaritin katër sekonda për rinisjet e mëposhtme:

- shkelmimi i topit për fillimin/rifillimin e lojës


- penallti




Fifth accumulated foul



Timeout



Advantage after DFK offence



Advantage after IFK offence



Caution (yellow card)



Sending-off (red card)


Faull i akumuluar: sinjali që do t'i bëhet mbajtësit të kohës dhe gjyqtarit të tretë pasi të jetë aplikuar avantazhi dhe topi të ketë dalë jashtë loje.



(Step I)



(Step II)



(Step III: two options)



Number of player – 1



Number of player – 2



Number of player – 3



Number of player – 4



Number of player – 5



Number of player – 6



Number of player – 7



Number of player – 8



Number of player – 9



Number of player – 10



Number of player – 11



Number of player – 12



Number of player – 13



Number of player – 14



Number of player – 15



Number of player – 30 (Step I)



(Step II)



Number of player – 52 (Step I)



(Step II)



Number of player – 60 (Step I)



(Step II)



Number of player – 84 (Step I)



(Step II)



Number of player – 90 (Step I)



(Step II)



Number of player – 96 (Step I)



(Step II)



Own goal (Step I)



(Step II)

2. Signal by both referees on restarting play



Indirect free kick

(the same signal only needs to be made by one of the referees when the free kick is awarded)

3. Signals by the assistant referees



Timeout



Fifth accumulated foul

Third referee or reserve assistant referee signals after a goal is scored when he/she is monitoring the goal line of the attacking team



(Step I)



(Step II)

POZICIONIMI

1. Pozicionimi me topin në lojë.

Rekomandimet:

- Gjyqtaret duhet të pozicionohen në mënyrë që loja të jetë midis gjyqtarit dhe gjyqtarit të dytë.
- Gjyqtarët duhet të përdorin një sistem diagonal.
- Qëndrimi në linjat kufizuese e bën me të lehtë punën e gjyqtareve.
- Një nga gjyqtarët duhet të jetë me afër aksionit por pa ndërhyrë në të.
- Arbitrat hyjnë në fushë vetëm për të pasur një pamje më të mirë të lojës.

"Ajo që duhet parë" nuk është gjithmone të qenit në afërsi të topit.

Arbitrat gjithashtu duhet t'i kushtojnë vëmendje:

- përballjeve agresive individuale të lojtarëve pa top;
- shkelje të mundshme në zonën e penaltisë drejt së cilës po shkon loja;
- shkeljet që ndodhin pasi topi ka dale jashtë;

2. Pozicionimi i përgjithshëm gjatë ndeshjes

Rekomandohet që një nga gjyqtarët të jetë në një linjë, ose me mbrapa, me lojtarin e parafundit të ekipit mbrojtës.

Arbitrat gjithmonë duhet të qendrojnë me fytyrë nga fusha. Një nga gjyqtarët duhet të kontrollojë zonën ku zhvillohet aksioni dhe gjyqtari tjetër duhet të kontrollojë zonat e tjera.

3. Portieri që lëshon topin

Njëri nga gjyqtarët duhet të qendrojë në pozicion paralel me portierin dhe të kontrollojë që ai/ajo të mos e prekë topin për herë të dytë pasi ta ketë futur në lojë dhe të mos dale jashtë zones të tij së penaltisë. Gjithashtu duhet të numerojë sekondat që portjeri zoteron topin.

4. Situatat "Gol /jo gol"

Kur një gol është shënuar dhe nuk ka dyshim për vendimin, gjyqtari dhe gjyqtari i dytë duhet të vendosin kontakt vizual dhe të sinjalizojnë golin. Gjyqtari që është me afër me tryezën e mbajtësit të kohës për të komunikuar numrin e lojtarit që ka shënuar golin.

Nëse një gol është shënuar, por loja ka vazhduar sepse situata është e paqartë, gjyqtari më i afërt me golin i bie bilbilit për të tërhequr vëmendjen e gjyqtarit tjetër, dhe pastaj sinjalizon shenimin e golit. Gjyqtari që është me afër me tryezën e mbajtësit të kohës për të komunikuar numrin e lojtarit që shënoi golin.

Kur një skuadër po luan me një portier “lojtar”, gjyqtari i tretë duhet të ndihmojë gjyqtarët brenda fushës duke marrë një pozicion në linjen e portes se ekipit që luan me portierin “lojtar” në mënyrë që të ketë një pamje më të mirë të situatave të “gol /jo gol”.

5. Pozicionimi në situata topi jashtë loje


Pozicioni më i mirë është ai nga i cili arbitrat mund të marri vendime të sakta dhe të ketë pamje optimale të lojës dhe lojtarëve. Pozicionet e sugjeruara në grafikët vijues janë themelore; disa janë rekomanduar për gjyqtarët dhe të tjerët janë të detyrueshme. Referenca për një "zonë" ka për qëllim të theksojë se çdo pozicion i rekomanduar është në të vërtetë një fushë brenda së cilës arbitrat kanë më shumë gjasa të marri vendime me efektive. Zona mund të jetë më e madhe, më e vogël ose me formë të ndryshme në varësi të rrethanave.

6. Pozicionimi në raste specifike


1. Pozicionimi – fillimi i lojës

Në fillimin e lojës gjyqtari i cili ndodhet në anën ku janë të vendosura zonat e zëvendësimit duhet të qendrojë në linjen e mesit të fushës.


Arbitri tjetër duhet të jetë në një linjë me lojtarin e parafundit.




2. Pozicionimi – Rivenia fundore



3. Pozicionimi – Goditja e kendit (1)




4. Pozicionimi – Goditja e kendit (2)




5. Pozicionimi – Goditje e lire (1)




6. Pozicionimi – Goditje e lire (2)




7. Pozicionimi – Goditje e lire (3)



8. Pozicionimi – Goditje e lire (4)




9. Pozicionimi – Penalltia e 6m



10. Pozicionimi – Penalltia e 10m




11. Pozicionimi – Penalltia e 10m (e egzekutuar ne vendin ku u krye faulli) (1)




12. Pozicionimi – Penalltia e 10m (e egzekutuar ne vendin ku u krye faulli) (2)




13. Pozicionimi- Rivenia anesore (1)




14. Pozicionimi- Rivenia anesore (2)




15. Pozicionimi- Rivenia anesore (3)




16. Pozicionimi- Rivenia anesore (4)




17. Pozicionimi- Rivenia anesore (5)



18. Pozicionimi- Penalltite qe vendosin fituesin e ndeshjes



19. Pozicionimi i arbitrit te trete nese nje ekip luan me nje portjer lojtar



INTERPRETIME DHE REKOMANDIME

Rregulli 3 - LOJTARET

Nëse një lojtar i cili del jashtë fushës me lejen e njërit prej arbitrave, por pa u zëvendësuar, rihyn në fushë pa leje nga njëri nga gjyqtarët ose gjyqtari i tretë dhe kryen një shkelje tjetër të paralajmërueshme, lojtari duhet të denohen për dy vepra të denueshme. (p.sh. nëse lojtari hyn pa leje nga një prej gjyqtarëve dhe pastaj pengon një kundërshtar në mënyrë të parregullt. Nëse kjo vepër kryhet me forcë të tepruar, lojtari ndeshkohet direkt.

Nëse një lojtar kalon aksidentalisht një nga vijat kufizuese të fushës, ai/ajo nuk konsiderohet se ka kryer shkelje të rregullave. Nëse një lojtar largohet nga fusha si pjesë e një lëvizjeje për të luajtur, ai/ajo nuk konsiderohet se ka kryer një shkelje.

Zëvendësuesit

Nëse një zëvendësues hyn në fushë në kundërshtim me procedurat e zëvendësimit ose bën që një ekip të luajë me një lojtar shtesë, gjyqtarët, të ndihmuar nga zyrtarët e tjerë të ndeshjes, duhet t'i përmbahen udhëzimeve:

- Ndaloni lojën, megjithëse jo menjëherë nëse avantazhi mund të zbatohet.
- Ndeshkoni zëvendësuesin për sjellje jo-sportive nëse ekipi luan me një lojtar shtesë ose për shkelje të procedurës së zëvendësimit nëse zëvendësimi nuk është bërë në mënyrë korrekte.
- Ndeshkoni zëvendësuesin nëse zëvendësuesi i mohon skuadrës kundërshtare një gol ose një mundësi të dukshme për shënim. Numri i lojtarëve zvogëlohet në përputhje me Rregullin 3, pavarësisht nëse shkelja konsiston në shkelje të procedurës së zëvendësimit ose për shkak se ekipi po luante me një lojtar shtesë.
- Zëvendësuesi duhet të largohet nga fusha në ndalesën tjetër të ndeshjes nëse ai/ajo nuk e ka lënë atë më parë - ose për të përfunduar procedurën e zëvendësimit, nëse shkelja ishte për këtë arsye, ose për të lëvizur në zonën teknike, nëse ekipi po luante me një lojtar shtesë.
- Nëse gjyqtarët aplikojnë avantazhin:
 - ata duhet të ndalojnë lojën nëse ekipi i zëvendësuesit ka kontroll te topit. Loja duhet të rifillojë me një goditje të lirë indirekte për skuadrën kundërshtare në vendin ku loja u ndal, përveç nëse loja ndalet brenda zona e dënimit (shih Rregulli 13);
- Nëse një zëvendësues hyn në fushë në vend të një lojtari të caktuar për fillimin e ndeshjes dhe gjyqtarët ose zyrtarë të tjerë të ndeshjes nuk janë të informuar për këtë ndryshim:
 - arbitrat lejojnë që zëvendësuesi i emëruar të vazhdojë ndeshjen;
 - nuk ndermarrin asnjë sanksion disiplinor ndaj zëvendësuesit;
 - arbitrat raportojnë incidentin tek autoritetet përkatëse.
- Nëse një zëvendësues kryen një xhest të denueshem para futjes në fushë, numri i lojtareve që fillojnë ndeshjen nuk zvogëlohet.

Largimi i autorizuar nga fusha

Përveç një zëvendësimi normal, një lojtar mund të largohet nga fusha pa lejen e gjyqtarit në situatat e mëposhtme:

- si pjesë e një lëvizjeje loje me të cilën lojtari kthehet menjëherë në fushe (p.sh. për të luajtur topin ose për të dribluar një kundërshtar) Sidoqoftë, nuk lejohet të largoheni nga fusha dhe të lëvizni pas njëres prej portave për të hyrë perseri në fushe me qëllim për të perfutuar nga ky pozicion. Nëse kjo ndodh, gjyqtarët duhet ndalojnë lojën nëse nuk mund të zbatojnë avantazhin.

Nëse e ndërpresin lojën, ata duhet ta rifillojnë atë me një goditje të lirë indirekte.

Lojtari paralajmërohet për largimin nga fusha.

- për shkak të lëndimit. Lojtarit i duhet leja e njërit prej gjyqtarëve për të hyrë perseri në fushë nëse lojtari nuk është zëvendësuar. Nëse lojtari ka pësuar gjakderdhje, gjakderdhja duhet të jetë ndalur para se lojtari të futet perseri në fushë dhe lojtari duhet të kontrollohet nga gjyqtarët ose njëri nga zyrtarët e tjerë të ndeshjes;
- për të korrigjuar ose vendosur perseri pajisjet e tij/saj. Lojtarit i duhet një nga leja e gjyqtarëve për të hyrë perseri në fushë nëse lojtari nuk ka qenë të zëvendësuar, dhe gjyqtarët ose një nga zyrtarët e tjerë të ndeshjes duhet të kontrollojnë pajisjet përpara se lojtari të kthehet në ndeshje.

Largimi i Paautorizuar nga fusha

Nëse një lojtar largohet nga fusha pa lejen e gjyqtarëve dhe për arsye që nuk parashikohen në Rregullat e Futsal, mbajtësi i kohës ose gjyqtari i tretë leshon sinjalin akustik për të informuar gjyqtarët nëse avantazhi nuk mund të zbatohet. Nëse është e nevojshme të ndalet loja, gjyqtarët sanksionojnë ekipin e lojtarit shkelës duke i dhënë një goditje të lirë indirekte skuadrës kundërshtare. Nëse aplikohet avantazhi, mbajtësi i kohës ose gjyqtari i tretë duhet të lëshojë sinjalin akustik në ndalesën tjetër të lojës. Lojtari paralajmërohet për largimin nga fusha pa lejen e gjyqtarit.

Numri minimal i lojtarëve

Edhe pse një ndeshje mund të mos fillojë nëse secila skuadër përbëhet nga më pak se tre lojtarë, numri minimal i lojtarëve, përfshirë edhe zëvendësuesit, të kërkuar për një ndeshje lihet në diskrecionin e shoqatave kombëtare të futbollit.

Një ndeshje mund të mos rifillojë nëse secila prej skuadrave ka më pak se tre lojtarë. Sidoqoftë, nëse një ekip ka më pak se tre lojtarë sepse një ose më shumë lojtarë janë larguar qëllimisht nga fusha, gjyqtarët nuk janë të detyruar ta ndërpresin ndeshjen menjëherë dhe avantazhi mund të zbatohet. Në rast të tilla, gjyqtarët nuk duhet të rifillojnë ndeshjen pasi të jetë ndalur loja nëse një skuadër nuk ka numrin minimal të tre lojtarëve.

Pijet freskuese

Arbitrat duhet të lejojnë lojtarët të marrin pije freskuese gjatë ndërprerjeve ose gjatë një ndalese në ndeshje, por vetëm jashtë fushës, në mënyrë që të mos laget parketi. Nuk lejohet futja e pijeve brenda fushës së lojës.

Rregulli 5 – GJYQTARET

Kompetencat dhe detyrat

Futsal është një sport konkurrues, dhe gjyqtarët duhet të kuptojnë se kontakti fizik midis lojtarëve është normal dhe një pjesë e pranueshme e lojës. Sidoqoftë, nëse lojtarët nuk respektojnë Rregullat e Futsal dhe Fair Play, gjyqtarët duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që ata të respektohen.

Arbitrat kanë fuqinë të paralajmërojnë ose të ndeshkojnë lojtarë, zyrtarë dhe skuadra që nga fillimi i ndeshjes deri pas përfundimit të saj. Gjithashtu gjatë kohës së shtesë dhe goditjeve të penalltive.

Avantazhi

Arbitrat mund të aplikojnë avantazhin sa herë që ndodh një shkelje e Rregullave të Futsal, por që nuk ndalojnë në mënyrë të qartë ndalimin nga zbatimi i avantazhit.

Zbatimi i avantazhit nuk lejohet për shkeljen e rregullit të katër sekondave, përveç nëse shkelja është kryer nga portieri në gjysmën e tij/saj të fushës kur topi është tashmë në lojë dhe ekipi i portierit menjëherë humbet zotërimin. Në rastet e tjera që përfshijnë këtë rregull (në goditjet e lira, goditjet indirekte, rivenjet fundore, rivenjet anësore dhe goditjet e këndit), gjyqtarët nuk mund të zbatojnë avantazhin.

Arbitrat duhet të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm për të vendosur nëse do të zbatojnë avantazhin:

- Ashpërsia e nderhyrjes: nëse nderhyrja ka qëllim të demtojë lojtarët, gjyqtarët duhet të ndalojnë lojën dhe ta ndeshkojnë lojtarin.
- Pozicioni ku është kryer faulli: sa më afër të jete porta kundërshtarë, aq më efektive mund të jetë përparësia.
- Shanset e një kundër-sulmi të menjëhershëm, premtues.
- Vepra e kryer nuk duhet të jetë e gjashtë ose më e madhe e një skuadre faulli i akumuluar, përveç nëse ka ndonjë mundësi për të shënuar një gol.
- Atmosfera e ndeshjes.

Vendimi për të ndeshkuar faullin fillestar duhet të merret brenda pak sekondash, por nuk është e mundur të kthehemi nëse sinjali përkatës nuk është dhënë më parë ose është lejuar një kalim i ri i lojës.

Nëse shkelja kërkon një kujdes, ajo duhet të lëshohet në ndalesën tjetër.

Sidoqoftë, nëse nuk ka një avantazh të qartë, rekomandohet që gjyqtarët të ndalojnë lojën dhe ta paralajmërojnë menjëherë lojtarin. Nëse kujdesi nuk jepet në ndalesën tjetër, nuk mund të - iuuuuu7

Nëse një shkelje kërkon që loja të rifillojë me një goditje të lirë indirekte, gjyqtarët duhet të zbatojnë avantazhin për të siguruar që loja të rrjedhë, me kusht që kjo të mos çojë në ndonjë hakmarrje dhe të mos jetë paragjyquese për ekipin kundër të cilit është kryer vepra.

Më shumë se një shkelje që ndodh në të njëjtën kohë

Kur kryhen më shumë se një shkelje në të njëjtën kohë, gjyqtarët ndëshkojnë shkeljen më të rëndë në aspektin e sanksionit, rifillimit, ashpërsisë fizike dhe ndikimit taktik.

Nëse shkeljet e kryera dënohen me një goditje direkte të lirë, atëherë arbitrat urdhërojnë që të regjistrohen faullat përkatëse të akumuluar.